

**PROTOKOLL
I TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR
PËR ADERIMIN
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Palët e Traktatit të Atlantikut Verior kanë nënshkruar në Uashington më 4 prill 1949.

Duke qenë të bindura se siguria e zonës së Atlantikut Verior do të rritet me aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në këtë Traktat,

Bien dakord si më poshtë vijon:

Neni I

Me hyrjen në fuqi të këtij Protokolli, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior i njofton Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, në emër të të gjitha Palëve, ftesën për tu pranuar në Traktatin e Atlantikut Verior. Në përputhje me nenin 10 të Traktatit, Republika e Maqedonisë së Veriut bëhet Palë në datën kur depoziton instrumentin e saj të aderimit tek Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni II

Ky Protokoll hyn në fuqi kur secila nga Palët e Traktatit të Atlantikut Verior ka njoftuar Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për pranimin e saj. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon Palët e Traktatit të Atlantikut Verior mbi datën e marrjes së këtij njoftimi, si dhe datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli.

Neni III

Ky Protokoll ku tekstet në gjuhën angleze dhe frënge janë njëloj autentike, depozitohet në Arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kopjet e njësuara me Protokollin dërgohen nga Qeveria e SHBA-ve tek Qeveritë e të gjitha Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit e pajisur me plotfuqi kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Nënshkruar në Bruksel më 6 shkurt 2019.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Mbretërinë e Belgjikës

Për Republikën e Bullgarisë

Për Kanadanë

Për Republikën e Kroacisë

Për Republikën Çeke

Për Mbretërinë e Danimarkës

Për Republikën e Estonisë

Për Republikën e Francës

Për Republikën Federale të Gjermanisë

Për Republikën e Greqisë

Për Hungarinë

Për Republikën e Islandës

Për Republikën e Italisë

Për Republikën e Letonisë

Për Republikën e Lituanisë

Për Dukatën e Madh të Luksemburgut

Për Malin e Zi

Për Mbretërinë e Hollandës

Për Mbretërinë e Norvegjisë

Për Republikën e Polonisë

Për Republikën e Portugalisë

Për Rumaninë

Për Republikën e Sllovakisë

Për Republikën e Sllovenisë

Për Mbretërinë e Spanjës

Për Republikën e Turqisë

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vula e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, datë 6.2.2019, është për të vërtetuar se ky dokument (i përbërë nga 9 fletë) është kopje e njëjtë me origjinalin.

Bruksel 6 shkurt 2019